

ثلاثة الأصول وأدلتها (للحرمين
(والجمعية

**TRI PARIMET DHE
ARGUMENTET E TYRE**

TRI PARIMET DHE ARGUMENTET E TYRE

Shejh Muhamed et-Temimi (Allahu e pastë mëshiruar!)

TRI PARIMET DHE ARGUMENTET E TYRE

Shejh Muhamed et-Temimi (Allahu e pastë mëshiruar!)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Dije – Allahu të mëshiroftë! – se e kemi për detyrë t'i mësojmë katër çështje:

E para: Dituria, që është njohja e Allahut, njohja e Profetit të Tij dhe njohja e fesë Islame me argumente.

E dyta: Zbatimi i dijes.

E treta: Predikimi i dijes.

E katërta: Durimi ndaj lëndimeve gjatë predikimit.

Dëshmi për këtë kemi fjalën e Allahut të Madhëruar: Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

﴿وَالْعَصْرُ 1 إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ 2 إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ 3﴾

Pasha kohën!

Me të vërtetë, njeriu është në humbje.

Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe për durueshmëri. (El-Asr, 1-3)

Imam Shafiu -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Sikur Allahu të mos kishte zbritur për krijesat e Tij asnjë argument, përveç kësaj sureje, ajo do t'u kishte mjaftuar."

Buhariu -Allahu e mëshiroftë!- ka shkruar në Sahihun e tij: Kapitulli: Dija e paraprin fjalën dhe veprën; argumenti i kësaj është fjala e të Lartësuarit: "Pra, dije se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe kërko falje për gjynahun tënd...!" [Muhamed: 9]. Pra, Allahu e nisi porosinë e Tij me dijen para fjalës dhe veprës.

Dije, -Allahu të mëshiroftë!- se për çdo musliman dhe muslimane është detyrë t'i mësojë këto tri çështje dhe të veprojë sipas tyre:

E para: se Allahu na krijoi, na furnizoi dhe nuk na la të jetojmë pa asnjë qëllim; por na dërgoi një të dërguar; kush i bindet atij, do të hyjë në Xhenet, e kush nuk i bindet, do të hyjë në Zjarr.

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ رَسُولًا ۖ فَعَصَىٰ فِرْعَوْنَ الرَّسُولَ فَأَخَذْنَاهُ أَخَذًا وَبِيلًا ۖ﴾ 16

"Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar si dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar Faraonit.

Por Faraoni nuk e dëgjoi të Dërguarin, andaj Ne e ndëshkuam ashpër." (El-Muzemmil, 15-16)

E dyta: se Allahu nuk është i kënaqur që dikush t'i bëhet ortak në adhurimin e Tij, as engjell i afërt e

as profet i dërguar. Argumenti i kësaj është fjala e të Lartësuarit:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾ (18)

"Xhamitë i përkasin vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!" (El-Xhin, 18)

E treta: se atij që i bindet të Dërguarit dhe e njëson Allahun, nuk i lejohet miqësia me atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jetë i afërmi më i ngushtë i tij.

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٍ مِّنْهُ وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ أُولَئِكَ حِزْبُ اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾ (22)

"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë njerëz që Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata janë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese." (El-Muxhadele, 22)

Dije — Allahu të udhëzoftë në bindje ndaj Tij! — se hanifizmi, feja e Ibrahimit, është: të adhurosh

Allahun Një të Vetëm, duke ia kushtuar Atij fenë sinqerisht. Për këtë i urdhëroi Allahu të gjithë njerëzit dhe për të i krijoi, siç thotë:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ (56)

"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë." (Edh-Dharijat, 56) Kuptimi i "të më adhurojnë" është: të më njësojnë.

Gjëja më madhështore për të cilën na ka urdhëruar Allahu është teuhidi. Teuhidi është njësimi i Allahut në adhurim.

Ndërsa gjëja më e madhe nga e cila na ka ndaluar është shirku. Shirku është t'i lutesh dikujt tjetër bashkë me Të.

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا...﴾

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)!" (En-Nisa, 36)

E nëse të pyesin: Cilat janë tri bazat që e ka për detyrë njeriu t'i njohë?

Atëherë thuaj: Njeriu e ka për detyrë të njohë Zotin e tij, fenë e tij dhe Profetin e tij (paqja qoftë mbi të!).

Parimi i parë:

E nëse të pyesin: "Kush është Zoti yt?"

Thuaj: Zoti im është Allahu, i cili kujdeset për mua dhe për të gjitha botët me begatitë e Tij. Ai është i Adhuruari im; nuk kam të adhuruar tjetër

pos Tij. Argumenti i kësaj është fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ 2﴾

"Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve."

[El-Fatiha: 2] Gjithçka përveç Allahut është botë, dhe unë jam një prej asaj bote.

E nëse të pyesin: Si e njohe Zotin tënd?

Thuaj: Me shenjat dhe krijesat e Tij.

Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna.

Ndër krijesat e Tij janë: shtatë qiejt dhe ç'ka në to, shtatë tokat dhe ç'ka në to, dhe ç'ka ndërmjet tyre.

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ 37﴾

"Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos u përulni (mos adhuroni) as për Diellin, as për Hënë, por, bëni sexhde për Allahun i Cili i ka krijuar ato, nëse jeni adhurues të Atij!" (Fusilet, 37)

Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ يُعْشِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ وَالنُّجُومُ مُسَخَّرَاتٌ بِأَمْرِهِ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ 54﴾

"Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me

errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë lëvduar Allahu, Zoti i botëve!" (El-Araf, 54)

Zoti është i adhuruari. Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ 21 الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ 22﴾

"O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).

Ai i Cili e ka bërë për ju tokën shtrojë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun!" (El-Bekare, 21-22)

Ibën Kethiri, -Allahu e mëshiroftë!- thotë: "Krijuesi i këtyre gjërave është i vetmi që meriton t'i kushtohet adhurimi."

Llojet e adhurimit për të cilat na ka urdhëruar Allahu janë: Islami, Imani dhe Ihsani. Ndër to janë gjithashtu edhe: lutja, frika, shpresa, mbështetja, lakmesa, frika, përlësia, droja, pendimi, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, kërkimi i shpëtimit, kurban, zotimi e lloje të tjera të adhurimit për të cilat na ka urdhëruar Allahu. Të gjitha këto i takojnë

vetëm Allahut të Lartësuar. Argument për këtë është Fjala e Tij:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾ (18)

"Xhamitë i përkasin vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!" (El-Xhin, 18)

Pra, ai që i kushton diçka prej këtyre formave të adhurimit dikujt tjetër përveç Allahut, është idhujtar, i pafe. Argumenti i kësaj është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ﴾ (117)

"Ai që pos Allahut, adhuron zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit." (El-Muminun, 117)

Në një hadith thuhet:

"الدُّعَاءُ مُحُ الْعِبَادَةِ."

"Lutja është thelbi i adhurimit."

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾ (60)

"Zoti juaj ka thënë: 'Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!'" (Gafir: 60)

Dëshmi për frikën (që konsiderohet adhurim) kemi ajetin kuranor:

﴿...فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

"Mos i kini frikë ata, por më kini Mua, nëse jeni besimtarë!" (Ali Imran: 175)

Dëshmi për shpresën kemi ajetin kuranor:

﴿...فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرَكَ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾

"Kështu, kush shpreson në takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!" (El-Kehf: 110)

Dëshmi për mbështetjen kemi ajetin kuranor:

﴿...وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

"Mbështetuni tek Allahu në qoftë se jeni besimtarë!" (El-Maide: 23) Po ashtu ajetin kuranor:

﴿...وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ﴾

"Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai." (Et-Talak, 3)

Argument për lakmesën, frikën dhe përluljen është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿...إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خُشِعِينَ﴾

"Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me lakmesë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh." (El-Enbija, 90)

Dëshmi për drojën kemi ajetin kuranor:

﴿...فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنَ...﴾

"Mos kini drojë nga ata, por nga Unë!" (El-Maide, 3)

Dëshmi për pendimin kemi ajetin kuranor:

﴿وَأَنِيبُوا إِلَى رَبِّكُمْ وَأَسْلِمُوا لَهُ...﴾

"Pendohuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij!"
(Ez-Zumer, 54)

Dëshmi për kërkimin e ndihmës kemi ajetin kuranor:

﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ۝٥﴾

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." (El-Fatiha, 5) Në një hadith thuhet:

"إِذَا اسْتَعْنَتْ فَاسْتَعِنْ بِاللَّهِ."

"Kur të kërkossh ndihmë, kërko nga Allahu!"

Argument për kërkimin e mbrojtjes është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ۝١﴾

"Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit!'." (El-Felek: 1)

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ۝١﴾

"Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve!'." (En-Nas, 1)

Dëshmi për kërkimin e përkrahjes kemi ajetin kuranor:

﴿إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَبَ لَكُمْ...﴾

"Ju kërkuat përkrahje nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj." (El-Enfal, 9)

Dëshmi për kurbanin kemi ajetin kuranor:

﴿قُلْ إِنْ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ 162 لَا شَرِيكَ لَهُ...﴾

"Thuaj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.

Ai nuk ka asnjë ortak..." (El-Enam, 162-163)
Dëshmi nga suneti kemi hadithin:

"لَعَنَ اللَّهُ مَنْ ذَبَحَ لِغَيْرِ اللَّهِ".

"Allahu e lëshoftë mallkimin e Tij mbi atë që ther kurban për dikë tjetër përveç Allahut!"

Dëshmi për zotimin është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿يُوفُونَ بِالْأَنذَرِ وَيَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا﴾

"Ata e përmbushin zotimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmerri i së cilës pushton gjithçka." (El-Insan, 7)

Parimi i dytë:

Njohja e fesë Islame me argumente. Islam do të thotë t'i nënshtrohesh dhe t'i dorëzohesh Allahut duke e besuar dhe adhuruar vetëm Atë, si dhe duke u larguar nga idhujtaria dhe ithtarët e saj.

Islami ndahet në tri grada: Islami (adhurimi), Imani (besimi) dhe Ihsani (përkryerja).

Dhe çdo gradë ka shtyllat e saj.

Shtyllat e Islamit janë pesë: Dëshmia se nuk ka të adhuruar përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut.

Argument për Shehadetin kemi ajetin kuranor:

﴿شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَانِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ﴾ (18)

"Allahu dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, mbajtës i drejtësisë. S'ka zot tjetër përveç Atij, Ai është i Plotfuqishmi, i Urti." (Ali-Imran, 18)

Kuptimi i shehadetit është: nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut.

Fjala "La ilahe" mohon gjithçka që adhurohet përveç Allahut.

Ndërsa fjala "il-lAllahu" pohon adhurimin për Allahun të Vetmin.

Ai nuk ka ortak në adhurimin e Tij, sikurse nuk ka ortak në sundimin e Tij.

Komentimi që e sqaron këtë është fjala e të Lartësuarit:

﴿وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِمَّا تَعْبُدُونَ 26 إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي..﴾

"(Kujto) kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: 'Në të vërtetë, Unë i urrej dhe s'kam të bëj fare me ato që adhuroni ju.

Përveç Atij që më ka krijuar." (Ez-Zuhruf, 26-27)
Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا آرِبًا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَإِن تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ﴾ (64)

"Thuaj: 'O ithtarët e Librit, ejani të biem dakord në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i

shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!' Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: 'Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!'" (Ali Imran, 64)

Dhe argumenti i dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut është Fjala e të Lartësuarit:

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ﴾ (128)

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Et-Teube, 128)

Ndërsa kuptimi i dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut është: bindshmëria ndaj urdhrave të tij, besimi në gjërat që ai ka treguar, largimi nga gjërat që i ka ndaluar dhe i ka kritikuar dhe të adhurohet Allahu vetëm nëpërmjet asaj që ai ka ligjësuar.

Argument për Namazin, Zekatin dhe shpjegimin e Teuhidit është ajeti:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ﴾ (5)

"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë." (El-Bejjine: 5)

Argument për agjërimin është ajeti kuranor:

(يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿183﴾)

"O besimtarë! Ju është bërë i detyrueshëm agjërimi, ashtu siç u qe bërë i detyrueshëm atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat." (El-Bekare, 183)

Argument për haxhin është ajeti kuranor:

(وَلِلّٰهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ اِلَيْهِ سَبِيْلًا وَمَن كَفَرَ فَاِنَّ اللّٰهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعٰلَمِيْنَ ﴿97﴾)

"Njerëzit i detyrohen Allahut vizitën e Shtëpisë (Qabes); kushdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd." (Ali Imran, 97)

Grada e dytë: Imani (besimi). Besimi është shtatëdhjetë e ca degë, më e larta e të cilave është dëshmia 'la ilahe il-lallah', ndërsa më e ulëta është largimi i pengesave nga rruga. Edhe turpi është degë e besimit."

Shtyllat e tij janë gjashtë: të besosh në Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe në Kaderin, qoftë i mirë apo i keq.

Dhe argumenti për këto gjashtë shtylla është fjala e Allahut të Lartësuar:

(لَيْسَ الْبِرُّ اَنْ تُوَلُّوْا وُجُوْهُكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلٰكِنَّ الْبِرَّ مَنۢ ءَامَنَ بِاللّٰهِ وَالْيَوْمِ الْاٰخِرِ وَالْمَلٰٓئِكَةِ وَالْكِتٰبِ وَالنَّبِيِّۦنَ...)

"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e

atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët..." (El-Bekare, 177)

Argumenti për Kaderin është ajeti kuranor:

﴿إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ﴾ (49)

"Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar." (El-Kamer, 49)

Grada e tretë: Ihsani (përkryerja). Ai ka vetëm një shtyllë të vetme: ta adhurosh Allahun sikurse të jesh duke e parë Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.

Argument për këtë është ajeti kuranor:

﴿إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ﴾ (128)

"Vërtet, Allahu është me ata që janë të devotshëm dhe që janë punëmirë." (En-Nahl, 128)

Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ﴾ 217 الَّذِي يَرْزُقُكَ حِينَ تَقُومُ 218 وَتَقُفُّكَ فِي السُّجُودِ 219

"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin.

i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit).

Dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulën në sexhde." (Es-Shuara, 217-219)

Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوا مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ...﴾

"Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o

njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të angazhoheni me të..." (Junus, 61) Deri në fund të ajetit.

Argument nga Suneti për këtë është hadithi i njohur i Xhibrilit, i cili transmetohet nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë:

"بَيْنَمَا نَحْنُ عِنْدَ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ ذَاتَ يَوْمٍ، إِذْ طَلَعَ عَلَيْنَا رَجُلٌ، شَدِيدُ بَيَاضِ الثِّيَابِ، شَدِيدُ سَوَادِ الشَّعْرِ، لَا يَرَى عَلَيْهِ أَثَرُ السَّفَرِ، وَلَا يَعْرِفُهُ مِنَّا أَحَدٌ، حَتَّى جَلَسَ إِلَى النَّبِيِّ ﷺ فَأَسَدَ رُكْبَتَيْهِ إِلَى رُكْبَتَيْهِ، وَوَضَعَ كَفَّيْهِ عَلَى فَخْذَيْهِ، وَقَالَ: يَا مُحَمَّدُ!

"Një ditë, ndërsa rrinim tek i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!), u shfaq një njeri me tesha fort të bardha dhe flokë fort të zinj, tek i cili nuk vëreheshin shenja udhëtimi. Atë nuk e njihte asnjëri prej nesh. U ul pranë Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!), duke i vendosur gjunjët e tij afër gjunjëve të të Dërguarit e duke i vënë shuplakat e duarve të tij mbi kofshët e veta, e tha: 'O Muhamed!

أَخْبِرْنِي عَنِ الْإِسْلَامِ؟

Më trego për Islamin?"

فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: الْإِسْلَامُ: أَنْ تَشْهَدَ أَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَتُقِيمَ الصَّلَاةَ، وَتُؤْتِيَ الزَّكَاةَ، وَتَصُومَ رَمَضَانَ، وَتَحُجَّ النَّبْتَ إِنْ اسْتَطَعْتَ إِلَيْهِ سَبِيلًا، قَالَ: صَدَقْتَ - فَعَجَبْنَا لَهُ، يَسْأَلُهُ وَيُصَدِّقُهُ -.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) tha: 'Islami është të dëshmosh se s'ka të adhuruar përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh ramazanin dhe, nëse ke mundësi, ta bësh haxhin në Qabe.' Ai tha: 'Të vërtetën the!' – Ne u

çuditëm me të, e pyeste dhe ia vërtetonte përgjigjen
-.

قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ الْإِيمَانِ؟

Tha: 'Më trego për besimin (imanin)?'

قَالَ: أَنْ تُؤْمِنَ بِاللَّهِ، وَمَلَائِكَتِهِ، وَكُتُبِهِ، وَرُسُلِهِ، وَالْيَوْمِ الْآخِرِ، وَتُؤْمِنَ بِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ، قَالَ: صَدَقْتَ.

Tha: 'Të besosh në Allahun, në melekët e Tij, në librat e Tij, në Ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin (paracaktimin), qoftë i mirë, qoftë i keq.' Tha: 'Të vërtetën the.'

قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ الْإِحْسَانِ؟

Tha: 'Atëherë, më trego për ihsanin?'

قَالَ: أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ، فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ.

Tha: 'Ta adhurosh Allahun sikurse të jesh duke e parë Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.'

قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنِ السَّاعَةِ؟

Tha: 'Atëherë, më trego për Kiametin?'

قَالَ: مَا الْمَسْئُولُ عَنْهَا بِأَعْلَمَ مِنَ السَّائِلِ.

Tha: 'I pyeturi nuk di më shumë për të se pyetësi.'

قَالَ: فَأَخْبِرْنِي عَنْ أَمَارَاتِهَا؟

Ai tha: 'Atëherë, më trego për shenjat e tij?'

قَالَ: أَنْ تَلِدَ الْأُمَةُ رَبَّتَهَا، وَأَنْ تَرَى الْخِفَاءَ الْعُرَاءَ الْعَالَةَ رِعَاءَ الشَّاءِ، يَتَطَاوَلُونَ فِي الْبُنْيَانِ.

Ai tha: 'Që robëresha të lindë zonjën e saj dhe të shohësh barinjtë e deleve, të zbathur, të zhveshur e të varfër, teksa garojnë në ndërtimet e larta.'

قَالَ: ثُمَّ انْطَلَقَ فَلَبِثْتُ مَلِيًّا، ثُمَّ قَالَ لِي: يَا عُمَرُ! أَتَدْرِي مَنِ السَّائِلُ؟ قُلْتُ: اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ، قَالَ: فَإِنَّهُ جَبْرِيلُ، أَتَأْكُمُ يَعْلَمُكُمْ دِينَكُمْ".

Pastaj, ai u largua, kurse ne qëndruam për një kohë. Më pas, më tha: 'O Umer, a e di kush është ai që pyeste.' Unë thashë: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.' Ai tha: 'Ai qe Xhibrili, erdhi për t'jua mësuar fenë.'"

Parimi i tretë:

Njohja e Pejgamberit, Muhammed (paqja qoftë mbi të!). Ai është Muhammedi, i biri i Abdullahut, i biri i Abdulmutalibit, i biri i Hashimit. Hashimi ishte nga fisi i kurejshëve. Kurejshët janë arabë, dhe arabët janë nga pasardhësit e Ismailit, birit të Ibrahimit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta dhe mbi pejgamberin tonë!).

Jetoi gjashtëdhjetë e tre vjet: dyzet vjet para profecisë dhe njëzet e tre vjet si profet dhe i dërguar.

U bë profet me shpalljen e vargjeve të para të sures 'el-Alek' dhe u bë i dërguar me shpalljen e sures 'el-Muddethir'. Qyteti i tij ku lindi dhe u rrit ishte Meka.

Allahu e dërgoi atë si paralajmërues kundër politeizmit dhe thirrës në monoteizëm. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ ۝ ۱ قُمْ فَأَنْذِرْ ۝ ۲ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ ۝ ۳ وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ ۝ ۴ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ ۝ ۵ وَلَا تَمْنُنْ تَسْتَكْثِرُ ۝ ۶ وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ ۝ ۷﴾

"O ti i mbështjellë (o Muhamed)!

Çohu dhe paralajmëro!
Zotin tënd madhëroje!
Petkat e tua pastroji!
Ruhu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!
Mos jep gjë me synimin që të marrësh më shumë!

Dhe për hir të Zotit tënd duro!" (El-Mudethir, 1-7)

Kuptimi i këtyre ajeteve:

﴿قُمْ فَأَنْذِرْ﴾:

"Çohu dhe paralajmëro!" Domethënë, paralajmëro nga politeizmi dhe thirr në monoteizëm!

﴿وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ﴾

"Zotin tënd madhëroje!"

Domethënë, madhëroje Atë duke e veçuar me adhurim.

﴿وَتِبْيَاكَ فَطَهِّرْ﴾

"Petkat e tua pastroji!"

Domethënë, pastroji veprat e tua nga shirku!

﴿وَالرِّجْزَ فَاهْجُرْ﴾

"Ruhu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!"

Ndyrësia janë idhujt. Dhe ruajtja prej tyre është braktisja dhe distancimi prej tyre dhe prej ithtarëve të tyre.

Kaloi dhjetë vjet duke thirrur në monoteizëm, dhe pas dhjetë vjetëve ndodhi mrekullia e miraxhit

(ngjitjes në Qiell) ku u bënë obligim pesë namazet. Në Mekë u fal tre vjet, pas bërjes së pesë namazeve obligim, dhe pas kësaj u urdhërua të bëjë hixhret (shpërngulet) në Medine.

Hixhreti është shpërngulja nga vendi i shirkut (idhujtarisë) në vendin e Islamit.

Hixhreti prej vendit të shirkut në vendin e Islamit, është obligim për këtë umet deri në Ditën e Kiametit.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّيْنَاهُمُ الْمَلَائِكَةُ طَالِمِي أَنْفُسِهِمْ قَالُوا فِيمَ كُنْتُمْ قَالُوا إِنَّا مُسْتَضْعَفُونَ فِي الْأَرْضِ قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضَ اللَّهِ وَسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا قَالُوا لَكَ مَا أُولَهُمْ جَهَنَّمَ وَسَاءَتْ مَصِيرًا 97 إِلَّا الْمُسْتَضْعَفُونَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا 98﴾

"Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me faje, u thonë: "Ku ishit?" Ata përgjigjen: "Ishim të pafuqishëm në Tokë". (Engjëjt)u thonë: "A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?" Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa i keq është ai vendbanim!

Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të ndërmarrin rrugë!" (En-Nisa, 97-98)

Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿لِعِبَادِي الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَسِعَةً فَإِنِّي فَاعْبُدُون 56﴾

"O robërit e Mi, që keni besuar! Toka Ime është vërtet e gjerë, andaj më adhuron vetëm Mua!" (El-Ankebut, 56)

Begaviu -Allahu e pastë mëshiruar!- ka thënë: "Shpallja e këtij ajeti lidhet me muslimanët e Mekës që nuk emigruan, të cilëve Allahu u bëri thirrje në emër të besimit."

Dëshmi për hixhretin nga Suneti është fjala e Profetit (paqja qoftë mbi të!):

"لَا تَنْقُطُ الْهَجْرَةُ حَتَّى تَنْقُطَ التَّوْبَةُ، وَلَا تَنْقُطَ التَّوْبَةُ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ مِنْ مَغْرِبِهَا."

"Hixhreti nuk ndërpritet derisa të ndërpritet pendimi, dhe pendimi nuk ndërpritet derisa të lindë Dielli nga perëndimi."

Pasi u vendos në Medine, u urdhërua me pjesën tjetër të ligjeve të Islamit – si: zekati, agjërimi, haxhi, ezani, xhihadi, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja – dhe në këtë gjendje kaluan dhjetë vjet.

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ndërroi jetë, por feja e tij do të vazhdojë të jetë. Kjo është feja e tij: nuk ka lënë të mirë pa ia treguar umetit, dhe as të keqe pa e paralajmëruar prej saj.

E mira në të cilën e ka udhëzuar është: njësimi i Zotit dhe gjithçka që Allahu e do dhe e pëlqen.

Kurse e keqja, prej së cilës Ai ka paralajmëruar, është shirku (idhujtaria) dhe gjithçka që Allahu i Lartësuar e urren dhe e refuzon.

Allahu i Lartësuar e dërgoi atë për gjithë njerëzimin dhe e bëri obligim bindjen ndaj Tij për xhindët dhe njerëzit. Argumenti i kësaj është fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا...﴾

"Thuaj (o Muhamed): 'O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju!'." (El-Araf, 158)

Me anë të tij, Allahu i Madhëruar e plotësoi fenë e Tij. Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

﴿...الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتِمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا...﴾

"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj." (El-Maide, 3)

Argument për vdekjen e tij është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَيِّتُونَ 30 ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخَصِّمُونَ 31﴾

"Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin.

Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!" (Ez-Zumer, 30-31)

Pas vdekjes njerëzit do të ringjallen. Argument për këtë është fjala e të Lartit:

﴿مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى 55﴾

"Prej tokës ju kemi krijuar, aty do t'ju kthejmë dhe nga ajo do t'ju nxjerrim edhe një herë tjetër." (Taha, 55) Po ashtu fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَاللَّهُ أَنْبَتُكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا 17 ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا 18﴾

"Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët,
pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju
nxjerrë." (Nuh, 17-18)

Pas ringjalljes, do të merren në llogari dhe do të
shpërblehen për veprat e tyre. Argument për këtë
është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿...لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسَاءُوا بِمَا عَمِلُوا وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحُسْنَى﴾

"...për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave
të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me
shpërblimin më të mirë." (En-Nexhm, 31)

E kushdo që e mohon Ringjalljen, ka dalë nga
Islami. Argument për këtë është fjala e Allahut të
Lartësuar:

﴿رَعِمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ وَذَٰلِكَ
عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ۝۷﴾

"Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen
kurrsesi. Thuaju: 'Po, për Zotin tim, me siguri që do
të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni
bërë!' Dhe kjo është e lehtë për Allahun." (Et-
Tegabun, 7)

Të gjithë të dërguarit që dërgoi Allahu ishin
përgëzues dhe paralajmërues. Argument për këtë
është fjala e të Lartësuarit:

﴿رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِنَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ...﴾

"Ne dërguam të dërguar përgëzues dhe
paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë
ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të
dërguarve..." (En-Nisa, 165)

I pari i tyre ishte Nuhu (paqja qoftë mbi të!).

I fundit ishte Muhamedi (paqja qoftë mbi të!), i cili është vula e profetëve, prandaj pas tij nuk ka profet. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ...﴾

"Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve..." (El-Ahzab, 40)

Argumenti se i pari prej tyre ishte Nuhu është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ...﴾

"Ne të zbritëm shpalljen ty (o Muhamed) ashtu siç ia zbritëm Nuhut dhe profetëve pas tij..." (En-Nisa, 163)

Çdo populli Allahu i dërgoi një të dërguar - prej Nuhut e deri te Muhamedi - që t'i urdhëronte të adhuronin vetëm Allahun dhe t'i ndalonte nga adhurimi i idhujve. Argument për këtë është fjala e të Lartësuarit:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطُّغُوتَ...﴾

"Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt..." (En-Nahl, 36)

Allahu ua ka bërë obligim të gjithë robërve: mohimin e tagutit dhe besimin në Allahun.

Ibën Kajimi, (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Tagut është çdo gjë me të cilën robi i tejkalon kufijtë e tij -

qoftë diçka që njerëzit e adhurojnë, e ndjekin apo i binden."

Tagutët janë të shumtë dhe krerët e tyre janë pesë: Iblisi – Allahu e mallkoftë, ai që adhurohet duke qenë vetë i kënaqur, ai që i fton njerëzit në adhurimin e vetes së tij, ai që pretendon se di diçka nga e fshehta, dhe ai që gjykon me tjetër gjë pos asaj që ka zbritur Allahu.

Dëshmi për këtë kemi ajetin kuranor:

{لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطُّغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدْ
أَسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ} (256)

"S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon tagutin (gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, është kapur pas lidhjes më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka." (El-Bekare, 256) Dhe kjo është pikërisht domethënia e "la ilahe il-lAllah". Në një hadith thuhet:

"رَأْسُ الْأَمْرِ: الْإِسْلَامُ، وَعَمُودُهُ: الصَّلَاةُ، وَذِرْوَةُ سَنَامِهِ: الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ."

"Kreu i çështjes është Islami, shtylla e tij është namazi, dhe kulmi i tij më i lartë është xhihadi në rrugën e Allahut."

Allahu është më i dituri.

Përmbajtja

TRI PARIMET DHE ARGUMENTET E TYRE	2
TRI PARIMET DHE ARGUMENTET E TYRE	2
Parimi i parë:.....	5
Parimi i dytë:	11
Parimi i tretë:	18

sq36v2.0 - 03/09/2026